VENDIM
Nr. 235, datë 18.8.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 44, DATË 11.2.2026, "MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË 'PARISOL' SHPK"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 175/7 prot., datë 13.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.2.2026, për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë 'Parisol' sh.p.k".

konstatoi se:

- Shoqëria "Parisol" sh.p.k është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024, i ndryshuar, për centralin fotovoltaik me kapacitet 2 mw në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 44, datë 11.2.2026, ka miratuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë.
- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të informojë ERE-n menjëherë pasi të disponojë/marrë miratimin përkatës të "Intesa SanPaolo Bank" sh.a. (konfirmimin nga banka mëmë), në lidhje me dakordësinë për ndryshimin e ortakut të shoqërisë, lidhur me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontratat e kredive të nënshkruara me bankën, më datë 18.4.2025.
- Në kuadër të përmbushjes së këtij kushti, me shkresën e fundit të përcjellë nr. 175/6 prot., datë 6.8.2026, shoqëria ka përcjellë deklaratën noteriale, datë 5.8.2026, të lëshuar nga "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a., e cila ka dhënë pëlqimin/dakordësinë për transferimin e kuotës të zotëruar nga ortaku z. M. D. tek z. A. Sh. Nëpërmjet kësaj deklarate, banka shprehet se për efekt regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), jep miratimin që z. M. D. (zotërues i 70% të kuotave të shoqërisë), të kalojë titullin e pronësisë të kuotave që zotëron tek z. A. Sh.
- Në rrethanat kur kushti i parashikuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 44/2026 tashmë është përmbushur, vlerësohet se kjo pikë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, me shfuqizimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 44/2026, vlerësohet e nevojshme edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi *nga*: "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 2, si dhe në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje" *në* "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.".
- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.2.2026, si vijon:

a) Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.2.2026, shfuqizohet;

b) Pika 4, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.2.2026, ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Parisol” sh.p.k për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti